



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 845/2022  
Datë: 29 korrik 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 29 korrik 2022, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Themelohet Komisioni për Rishqyrtim, në këtë përbërje:
  1. Veton Shabani, Zëvendëskryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës - Kryesues;
  2. Shqipdon Fazliu, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit - anëtar;
  3. Ikramije Bojaxhiu, Prokurore në Prokurorinë e Apelit - anëtare.
- II. Anëtarë rezervë të Komisionit për Rishqyrtim do të jenë:
  1. Merita Bina-Rugova, Anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
  2. Sebahate Sinani, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.
- III. Obligohen anëtarët nga pikat I dhe II të këtij Vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në uebportalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve në pikën I dhe II të Vendimit;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.